



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.355/2020


GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare, Ramiz Kuqi dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas paditësit-propozuesit Sami Kurteshi, nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson Getoar Mjeku, kundër të paditurit-kundër propozuesit, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në Prishtinë, dhe palët me interes juridik, “VBS” shpk, “Vita Energy” shpk, “Abrazen” L.L.C., Energy Development Group Kosova shpk., “Solar Gate” L.L.C dhe “Alsi & Co-Kosovë” L.L.C shpk, “Building Construction”, përfaqësuar me autorizim nga Faton Qirezi dhe Alban Makolli, avokat në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit-kundër propozuesit, ankesën e palëve të interesuara, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.3090/2019, të datës 06.04.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.06.2020, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesa e të paditurit-kundër propozuesit Zyra e Rregullatorit për Energji, e datës 10.06.2020, ankesa e palëve të interesuara VBS shpk, Vita Energy shpk, Abrazen L.L.C., Energy Development Group Kosova shpk., Solar Gate L.L.C dhe Alsi & Co-Kosovë L.L.C shpk, Building Construction, e datës 22.04.2020, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3090/2019, i datës 06.04.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, është aprovuar si e bazuar kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të



vendimit, e parashtruar nga paditësi Sami Kurteshi nga Prishtina dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit të të paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) e Republikës së Kosovës në Prishtinë, V_1204_2019 i datës 27 nëntor 2019, deri në vendimin definitiv gjyqësor sipas padisë.

Kundër këtij Aktvendimi ankesë ka ushtruar e paditura ZRRE, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit për Konfliktet Administrative, shkeljen e dispozitave ligjore të Ligjeve të Sektorit të energjisë dhe akteve nënligjore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ta anuloj.


Kundër këtij aktvendimi kanë ushtruar ankesë palët e interesuara VBS shpk, Vita Energy shpk, Abrazen L.L.C., Energy Development Group Kosova shpk., Solar Gate L.L.C dhe Alsi & Co-Kosovë L.L.C shpk, Building Construction, me të cilën e kanë kundërshtuar aktvendimin e ankimuar për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative dhe kontstatimit të gabuar të gjendjes faktike. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e ushtruar nga ankuesit –palët e interesit VBS shpk, Vita Energy shpk, Abrazen L.L.C., Energy Development Group Kosova shpk., Solar Gate L.L.C dhe Alsi & Co-Kosovë L.L.C shpk, Building Construction, të anulohet Aktvendimin nr.3090/19 i datës 06.04.2020, refuzohet kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të ZRRE V_1204_2019, i datës 27.11.2019.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar përgjigje në ankesë, me të cilën i ka kundërshtuar ankesat e palëve në procedurë, duke i propozuar gjykatës që të hidhet poshtë si e palejuar ankesa e palëve të vet identifikuar si VBS shpk, me numër biznesi 70325365 dhe Building Construction, pa adresë ose numër identifikues. Të refuzohet si e pathemeltë ankesa e palëve të interesuara “Alsi & Co-Kosovë LLC shpk, me numër identifikues 810875552, Vita Energy” shpk, Abrazen LLC, Energy Development Group Kosova shpk dhe Solar Gate LLC, vërtetohet aktvendimi i datës 06.04.2020 i i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në lëndën A.nr.3090/19.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesat janë të **pabazuar**.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka aprovuar kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit V_1204_2019 i datës 27 nëntor 2019, me arsyetimin se paditësi nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës,



e ka bërë të besueshme kërkesën e tij, se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi do t'i sjellë dëm, i cili dëm vështir do të riparohej dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës së kundërt. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet nga neni 22.2, i Ligjit për Konfliktin Administrativ, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues. Këtë vlerësim gjykata e mbështet në faktin se paditësi ka ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm paditësit i cili dëm vështir do të riparohej. Gjithashtu, gjykata gjeti se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar.


Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me padi ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ V_1204_2019 i datës 27 nëntor 2019, deri në marrjen e një vendimi gjyqësor, me arsyetim se me ekzekutimin e vendimeve të kontestuar propozuesit, do t'i sillte dëm të konsiderueshëm dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk i shkakton dëme palës kundërshtare dhe personave të interesuar.

Pretendimet ankimore të palës së paditur, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës jo kontestimore, siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesve, me rastin e aprovimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.

Meqë në këtë rast e paditura dhe palët e interesuara në ankesat e ushtruara nuk e kanë bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e tyre. Sipas vlerësimit të kolegjit të



kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesat si e tilla refuzohen, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.355/2020, me datë 17.06.2020

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi

